



VENDIM PËR PAPANUESHMËRI

Data e miratimit: 23 nëntor 2011

Numri i lëndës 2011-13

Z. Sllobodan Martinovic

Kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 23 nëntor 2011, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Z. Antonio BALSAMO, kryesues
Znj. Magda MIERZEWSKA, anëtare
Znj. Anna BEDNAREK, anëtare

Asistuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Leena LEIKAS, zyrtare ligjore
Znj. Stephanie SELG, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetorit 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit me 9 qershor 2010,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PARA PANELIT

1. Ankesa ishte regjistruar më 21 prill 2011.

II. FAKTET

1. Faktet e rastit, siç janë paraqitur nga parashtruesi i ankesës, dhe siç shihen prej dokumenteve në dispozicion të Panelit, mund të përmbliidhen si në vijim.

2. Sipas parashtruesit të ankesës, herët në mëngjesin e datës 23 shtator 2009, policët e EULEX-it kishin hyrë në shtëpinë e tij dhe kishin arrestuar atë. Në atë kohë ai ishte duke fjetur dhe ishte zgjuar nga gjumi pas zhurmës që ishte shkaktuar nga hyrja brenda. Personat i bërtisnin atij dhe familjes së tij në një gjuhë që ai nuk e kuptonte.
3. Dysohet se policët kishin drejtuar armët e tyre në drejtim të parashtruesit të ankesës dhe familjes së tij, përfshirë edhe dy mbesat e tij. Pas nja pesëmbëdhjetë (15) minutash, një përkthyes kishte arritur dhe ia kishte shpjeguar urdhrin për arrest parashtruesit të ankesës. Ai ishte arrestuar dhe ishte sjellë në stacionin policor të EULEX-it për rreth dhjetë (10) orë dhe pastaj ishte dërgua në qendron për paraburgim.
4. Pas diku njëzet e katër (24) orësh në paraburgim, me datën 24 shtator 2009, parashtruesi i ankesës ishte urdhëruar nga një gjykatës i procedurës paraprake që të mbahej në paraburgim në Prishtinë për tridhjetë (30) ditë. Kohëzgjatja e paraburgimit të tij ishte vazhduar për edhe gjashtëdhjetë (60) ditë të tjera më 21 tetor 2009. Avokati i tij kishte parashtruar një ankese kundër urdhrin për paraburgim me datën 24 tetor 2009, mirëpo ajo ishte hedhur poshtë me arsyetim se ai paraqiste rrezik që të largohej.
5. Pas nja dy (2) muajsh qëndrimi në paraburgim, parashtruesi i ankesës ishte marrë në pyetje nga një prokuror i EULEX-it me datën 2 dhjetor 2009.
6. Ai ishte liruar nga paraburgimi me datën 16 dhjetor 2009 dhe ishte urdhëruar që të paraqitej në Shtabin Rajonal të Policisë në Gjilan dy herë në muaj. Gjithashtu ai ishte ndaluar që të largohej nga territori i Kosovës dhe ishte urdhëruar që mos të kontaktonte viktimat e supozuara.
7. Urdhri që ai të paraqitej ishte shfuqizuar me datën 16 mars 2010, mirëpo atij ende i ndalohej që të largohej nga Kosova. Ai nuk dëgjoj asgjë më tepër nga Gjykata e Qarkut e Prishtinës pasi ishte liruar dhe se kishte menduar se rasti ishte mbyllur nga EULEX-i.

Përafërsisht gjashtë (6) muaj pas lirit të tij, ai ishte dërguar për kujdes mjekësor në një qendër shëndetësore në Republikën e Serbisë. Avokati i tij kishte bërë një kërkesë për në gjykatë, duke kërkuar që të heq urdhrin e datës 16 dhjetor 2009. Kjo kërkesë ishte hedhur poshtë me datën 5 gusht 2010.
8. Më 19 dhjetor 2010, parashtruesi i ankesës ishte njoftuar rreth seancës gjyqësore për vërtetimin e pikave të aktakuzës. Më pastaj, lidhur me padinë ishin mbajtur përafërsisht tre seanca.
9. Me 22 korrik 2011, parashtruesi i kërkesës u liruar si i pafajshëm përmes një aktvendimi të marrë nga Gjykata e Qarkut e Prishtinës.

III. ANKESAT

10. Parashtruesi i ankesës pohon se periudha e kaluar në paraburgim ishte shumë e vështirë për të, për shkak se ishte ndarë nga familja e tij. Familja e tij ishte lejuar që vizitonte atë diku dhjetë (10) ditë pasi ai ishte marrë në paraburgim. Gjatë kësaj periudhe, ai nuk e dinte se çfarë i kishte ndodhur familjes së tij. Rrjedha e ngjarjeve kishte pasur një ndikim jo të mirë në shëndetin e tij, e që shfaqej me presion të lartë të gjakut, probleme me fshikëz dhe humbje të papritur në peshë. Për më tepër, ndjenja e padrejtësisë posaçërisht ishte e rëndë, pasi që ai ishte akuzuar për diçka që kurrë nuk do ta bënte.
11. Parashtruesi i ankesës mendon se policët e EULEEX-it dhe prokurori i EULEX-it kishin përdorur forcë të tepruar; kishin arrestuar atë për dy muaj pa e marrë në pyetje dhe ia kishin mohuar të drejtën e tij për jetë private dhe familjare, kishin vepruar në mënyrë jo njerëzore; i kishin shkaktuar vuajtje të madhe mendore dhe fizike; i kishin shkelur ndershmërinë e tij fizike; kishin shkelur dinjitetin e tij; kishin poshtëruar atë dhe kishin shkelur të drejtën e tij për gjykim brenda një afati të arsyeshëm.

IV. LIGJI

Kushtet e përgjithshme të procedurës për pranueshmëri

12. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranojë ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Rregullën 29 të Rregullores së Punës (RrP).
13. Paneli mund të shqyrtojë vetëm ato ankesa që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në drejtës, polici dhe dogana, siç përcaktohen në Rregullën 25, paragrafi 1 i Rregullores së vet të Punës.
14. Sipas Rregullës të përmendur më lart, bazuar në konceptin e llogaridhënies në PLANIN OPERATIV të EULEX-it në Kosovë, Paneli nuk mund të shqyrtojë procedurat ligjore që janë para gjykatave të Kosovës. Në veçanti, nuk është funksion i tij që të merret me gabimet e faktit apo ligjit që supozohet të jenë kryer nga gjykatat vendore, përveçse apo në atë masë sa do të kishin shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga ligji ndërkombëtar i të drejtave të njeriut i zbatueshëm në Kosovë.

Kohëzgjatja e tepërt e dyshuar e procedurave penale

15. Sa i përket kohëzgjatjes së tepërt të dyshuar të procedurave penale para Gjykatës, kjo ankesë ka të bëjë me procedura juridike të kryera para gjykatave në Kosovë. Prandaj, Paneli konstaton se sipas Rregullës 25 të Rregullores së Punës, nuk ka kompetencë për të shqyrtuar pajtueshmërinë e procedurave gjyqësore me standardet e

të drejtave të njeriut (gjithashtu shih vendimin e Panelit në lëndën e SH.P.K. “SYRI” kundër EULEX-it, 2011-05, Vendimi i datës 14 shtator 2011). Në secilin rast, Paneli konsideron se procedurat penale kundër parashtruesit të ankesës të cilat ishin ende në pritje para gjykatave për dy vite, nuk ngrehin ndonjë çështje sa i përket përputhshmërisë së tyre me të drejtën që të dëgjohet rasti brenda afatit të arsyeshëm.

16. Përkundrazi, Paneli konstaton se veprimet apo jo veprimet nga ana e prokurorëve gjatë fazës së hetimit të procedurave penale mund që mos të konsiderohen se janë marrë në kontekst të “procedurave juridike” dhe se “veprimet dhe jo veprimet e prokurorëve të EULEX-it [...] para dorëzimit të padisë mund të bien në kuadër të mandatit ekzekutiv të EULEX-it” (shih, vendimin e PShDNj Sadik Thaqi kundër EULEX-it, 2010-02, Vendimi i datës 14 dhjetor 2011, Paragrafët 674 dhe 93).

Përmbushja e kërkesës për gjashtë muaj

17. Në përputhje me Rregullën 25, paragrafi 3 i Rregullores së Punës¹ ankesat duhet të dorëzohen brenda tre muajve nga data kur Paneli mund t'i pranoj ankesat (9 qershor 2010), apo brenda gjashtë muajve nga data e shkeljes së dyshuar, cila do që të jetë më e përshtatshme për parashtruesin e ankesës.

18. Lidhur me shkeljet e dyshuara të të drejtave të njeriut të shkaktuara nga veprimet e policisë së EULEX-it dhe prokurorisë së EULEX-it gjatë arrestimit të parashtruesit të ankesës dhe pastaj të bastisjes së shtëpisë më 23 shtator 2009, ankesa duhej të ishte parashtruar jo më vonë se data 9 shtator 2010. Kjo ankesë ishte parashtruar në Panel për afërsisht 19 muaj më vonë, me datën 21 prill 2011. Ankesa sa i përket këtyre ngjarjeve nuk e plotëson kriterin e pranueshmërisë të përcaktuar në Rregullën 29 të RrP-së.

PËR KËTO ARSYE, PANELI NJËZËRI

konstaton se një pjesë e kësaj ankesë është parashtruar në Panel jashtë afatit, i cili është përcaktuar në Rregulloren e Punës, dhe se nuk ka kompetencë për të shqyrtuar pjesën tjetër të ankesës, dhe

gjen se ankesa është e pabazuar sipas Nenit 29 (d) të Rregullores së vet të Punës, dhe

SHPLL ANKESËN TË PAPANUESHME.

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor

Antonio BALSAMO
Kryesues i Panelit

¹ Siç është shprehur në versionin në fuqi të datës 9 qershor 2010, në kohën kur është parashtruar kjo ankesë.